



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. Nr. 01/ 1725

Datë: 04.11.2020

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të Statutit të Universitetit si dhe vendimit të MASH, Nr. 2266 dt.17.09.2020 për aprovimin e kuotave për regjistrimin e studentëve të rinj në studime Master në UKZ, shpall:

KONKURS PLOTËSUES

për pranimin e studentëve të rinj, në vitin e parë në studimeve MASTER në vitin akademik 2020/2021

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve MASTER, për vitin akademik 2020/2021, do të regjistrojë **45** studentë të rregullt në dy programet e studimit: E-Qeverisja dhe Qeverisja lokale dhe Shoqëria demokratike.
2. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **12** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT dhe Senati, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja **2%**. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri **2** studentë. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërsënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **2 %** e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht **2** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **1 %** e kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht **1** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
6. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses studimet themelore në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
7. Kandidatet te cilet kane diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
8. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
9. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
10. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit "Kadri Zeka" nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
11. Kandidatët për pranim si studentë në nivelin master në Universitetin "Kadri Zeka" në vitin akademik 2020/21 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë

- Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;

- Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë.

1. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
2. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
3. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
4. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në zyrën e shërbimeve Master në UKZ, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

III.

IV. AFATET E KONKURSIT

Për pranimin e aplikacioneve për kandidatët e paraqitur për studime master, oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **05.11.2020** deri më **11.11.2020** nga ora 9.00 deri në orën 16.00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- a) Ekstraktin e lindjes (origjinal),
- b) Diplomën e fakultetit (origjinal ose të noterizuar), ose certifikatën e diplomës origjinale Kopjen e letërnjoftimit,
- c) Fletëparaqitjen e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online
- d) Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT)
- e) Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti:
- f) Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://uni-gjilan.net>
- g) Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, ndërsa pagesa bëhet në bankë.

P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve publikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.

1. Njoftimet, data dhe ora e mbajtjes së provimit pranues do të publikohen në ueb-faqen e universitetit të enjten më **12.11.2020**.
2. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më **të hënën më 16.11.2020** në ueb-faqen e universitetit dhe në shërbimin e studimeve master.
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

5. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen shërbimit të studentëve të Masterit ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

V. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë shërbimit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës më datë **18.11.2020 duke filluar nga ora 10.00.**
- Rezultatet përfundimtare pas ankesave do të publikohen më **19.11.2020.**

VI. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

Regjistrimi i studentëve të pranuar do të bëhet sipas njoftimit nga Zyra e TI-së, i cili do të publikohet në.

- Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.

4. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet nga SMU.
 - Pagesa për një semestër për studentë është në lartësi prej 150.00 €, sipas Udhëzimit Administrativ nr.17/2014 të datës 6.05.2014.
- Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

I. PROGRAM I PËRBAHKËT I FAKULTETIT TË SHKENCAVE KOMPJUTERIKE , FAKULTETIT EKONOMIK DHE FAKULTETIT JURIDIK PROGRAMI MASTER E-QEVERISJE

Në vitin e parë të studimeve master do të regjistrojë **16** studentë:

PROGRAMI	NGA KOSOVA	NGA LUGINA E PRESHEVES 2%	Komunitetet jo shumicë 12%	Nga Maqedonia dhe Shqipëria 2%	Nga Mali i Zi 1%	Gjithsej
Gjithsej	8	1	6	1	/	16
E - QEVERISJE	8	1	6	1	/	16

E-Qeverisja është program i përbashkët tri fakulteteve që do ti ndajnë vendet e lira në mënyrë të barabartë (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik).

PROVIMI PRANUES

1.Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale nga tri fakultetet përkatëse varësisht nga drejtimi bazë si dhe pyetje logjike.

II. PROGRAM I PËRBASHKËT I UNIVERSITETIT “KADRI ZEKA” NË GJILAN, UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” NË PRIZREN DHE UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA” NË PEJË

PROGRAMI QEVERISJA LOKALE DHE SHOQËRIA DEMOKRATIKE

Në vitin e parë të studimeve master do të regjistrojë **29** studentë:

PROGRAMI QLSHD	NGA KOSOVA	NGA LUGINA E PRESHEVES 2%	Komunitetet jo shumicë 12%	Nga Maqedoni a dhe Shqipëria 2%	Nga Mali I Zi 1%	Gjithsej
Universiteti “Kadri Zeka”	8	1	0	1	0	10
Universiteti “Ukshin Hoti”	6	0	3	0	0	9
Universiteti “Haxhi Zeka”	6	0	3	0	1	10

PROVIMI PRANUES

1. Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale nga tri fakultetet përkatëse; Juridik, Ekonomik , Shkenca Politike, Administratë dhe Gjuhë Angleze.
2. Në rast se numri i vendeve nuk plotësohet nga universitetet partnere, atëherë numri mund të plotësohet nga secili partner, deri në numrin e lejuar nga AKA.